# AKT THEMELIMI
## I
## SHOQERISE " VELLEZERIT HYSA " SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.08.1991,"per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private,te nismes se lire,te veprimtarise private te pavarur te privatizimit" dhe ne zbatim te ligjit nr.7638 date 10.10.1992 "per shoqerite tregtare" behet themelimi i shoqerise me emertimin "Vellezerit Hysa",shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,me seli ne fshatin Kamuna,Komuna Mollas,rrethi Elbasan e mbeshtetur ne statutin e kesaj shoqerie me ortake zoterinjte Agron Hysa,Besnik Hysa dhe Kujtim Hysa, shtetas shqiptare.

VENDOSIN:

Te krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Vellezerit Hysa" me kushtet e meposhteme:

NENI 1

Themeluesit ne cilesine e ortakeve krijojne shoqerine "Vellezerit Hysa" me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me mjetet e veta financiare dhe duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik me rregjistrin e saj ne rregjistrin tregtar dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi,nga ky akt themelimi dhe statuti bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "Vellezerit Hysa" sh.p.k.,emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat,faturat etj.. Ajo ka vulen e saj ne te cilen shkruhet :Shoqeria "Vellezerit Hysa" sh.p.k. Elbasan-Albania.

NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne rrethin e Elbasanit,Fshati Kamuna,Komuna Mollas.Ajo mund te hape perfaqesi,dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

NOTER ELBASAN



NENI 5

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet mbi 10 vjet.Pas mbarimit te ketij afati ortaket mund te vendosin per shtyrje te ketij afati.

NENI 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
"Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,pjese kembimi pajisje e makineri ,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregtim te materialeve ndertimore,pleherave kimike, punime duroalumini dhe tregetim materialesh duroalumini dhe druri, grumbullimi dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore,tregtimi me pakice i karburanteve dhe i vajrave lubrifikante.

Ndermarje ndertimi per llogari te vet dhe te te treteve ne ndertime civile, industriale,ushqimore,bujqesore,turistike dhe kompletimin e tyre me instalimet e nevojshme elektrike,mekanike,hidraulike dhe hidrosanitare.Prodhim te inerteve prej guri dhe lumi,te elementeve prej betoni dhe beton armeje dhe tregtim te tyre".

NENI 7

Me vendimin e themeluesve te saj shoqeria mund te ndryshoje emrin,seline,formen juridike dhe objektin e veprimtarise pas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lke dhe perfaqesoj kontributet ne para te ortakeve te saj.Ky kapital ndahet ne 100 kuota te barabarta me nga 1000 lke secila.

Ortaku Agron Hysa zoteron 40% te kapitalit.
Ortaku Kujtim Hysa zoteron 30% te kapitalit.
Ortaku Besnik Hysa zoteron 30% te kapitalit.

NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj ekonomike per te realizuar fitime.Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te trete.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese,ekonomike dhe financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe me dispozitat e statutit bashkelidhur.

Themeluesit me vendim te vecante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel.Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhme me ligjin "per kontabilitetin" si dhe do te krijoje fondin rezerve.Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjet e martuar nga vitet e meparshme do t'i kaloje ortakeve.

NENI 11

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise,numri i punonjesve dhe emertimet dhe shkarkimet ne organet e saj behen nga Asambleja e Ortakeve.Marredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Shoqeria "Vellezerit Hysa" ka caktuar si administratore te saj z.Agron Hysa

NENI 13

Te gjitha kundershtimet eventual midis ortakeve te shoqerise zgjidhen ne gjykaten e Tiranes,vendimet e se ciles jane te formes se prere.Ortaket zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis tyre mund ta zgjidhin edhe me procedura te tjera te miratuara nga asambleja e shoqerise dhe te zbatueshme.

NENI 14

Rregullat per drejtimin,organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij akt themelimi.

THEMELUESIT E SHOQERISE "Vellezerit Hysa"SH.P.K.

| Agron Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |
|---|---|---|
| Agron Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |

# S T A T U T

## *I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR*
## *"VELLEZERIT HYSA" SH.P.K*

Shoqeria "Vellezerit Hysa" sh.p.k krijohet ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "per shoqerite tregetare".

### KREU I
### *DISPOZITA TE PERGJITHSHME*

#### NENI 1

Shoqeria "Vellezerit Hysa"sh.p.k eshte person juridik shqiptar.Ajo gezon personalitetin juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregetar dhe ne zyren e Tatimeve.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e themelimit(Akti i Themelimit dhe Statuti).

#### NENI 2

Shoqeria "Vellezerit Hysa" sh.p.k eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,me seli ne fshatin Kamunah,Komuna Mollas,rrethi Elbasan.Ajo mund te cele zyra perfaqesie dege ose filiale ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

#### NENI 3

Shoqeria "Vellezerit Hysa"sh.p.k parashkohet te zhvilloje veprimtarine e saj per nje kohe mbi 10 vjetesh,me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj para ketij afati ose kur vendos shtyrjen e veprimtarise se saj tej afatit te mesiperm.

#### NENI 4

Emertimi i shoqerise eshte "Vellezerit Hysa"sh.p.k. Ky emertim vendoset ne te gjithe letrat qe perdoren per korrespodence ne faturat,ne te gjitha reklamat dhe

botimet e nxjerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala Sh.P.K ose "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" nga numri i regjistrimit te saj dhe selia.

## KREU II
## *OBJEKTI I VEPRIMTARISE*

### NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
"Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,pjese kembimi pajisje e makineri ,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregtim te materialeve ndertimore,pleherave kimike, punime duroalumini dhe tregetim materialesh duroalumini dhe druri, grumbullimi dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore,tregtimi me pakice i karburanteve dhe i vajrave lubrifikante.

Ndermarje ndertimi per llogari te vet dhe te te treteve ne ndertime civile, industriale,ushqimore,bujqesore,turistike dhe kompletimin e tyre me instalimet e nevojshme elektrike,mekanike,hidraulike dhe hidrosanitare.Prodhim te inerteve prej guri dhe lumi,te elementeve prej betoni dhe beton armeje dhe tregtim te tyre".

### NENI 6

Ortaket rezervojne te drejten te modifikojne objektin e veprimtarise ne cdo kohe.

## KREU III
## *KAPITALI THEMELTAR*

### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributet ne para te nenshkruara e te shlyera nga ortaket.Kapitali themeltar eshte 100.000 leke i ndare ne 100 pjese te barabarta me nga 1000 leke secila.
Ortaku Agron Hysa zoteron 40% te kapitalit.
Ortaku Kujtim Hysa zoteron 30% te kapitalit.
Ortaku Besnik Hysa zoteron 30% te kapitalit.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket e shoqerise.Ne rast zmadhimi te kapitalit fillestar nepermjet shtimit te pjeseve te reja ortaket kane te drejten e perfaqesise per nenshkrimin, perpjestimisht me kuoten e tyre ne formimin e kapitalit themelor,pra jane te lire te heqin dore nga nje e drejte e tille.Ne rast zvogelimi te kapitalit atehere preken

kuotat e secilit ortak ne menyre perpjestimore.Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

## KREU IV
## *ORGANET E SHOQERISE*

### NENI 8

Ortaket ushtrojne kompetencat qe i jane caktuar Asamblese se ortakeve,ne baze baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992,"Per shoqerite tregetare".Ata marin vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregetare te saj. Asambleja e shoqerise sh.p.k "Vellezerit Hysa" perbehet prej ortakeve themelues te shoqerise.

Asambleja eshte organi sovran i shoqerise.Themeluesit qeverisin veprimtarine e shoqerise duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te pronesise private mbi mjetet e investuara ne shoqeri.

Asambleja e shoqerise percakton e miraton te drejtat dhe detyrat e organeve te saj,Administratorin e Administratoreve te emeruar etj.Te zgjedhurit dhe te emeruarit nga asambleja veprojne ne perputhje me dispozitat e ketij statuti e akt themelimi si dhe ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Vendimet qe merr Asambleja sipas ketij Statuti dhe Legjislacioni shqiptar ne fuqi jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise.Secili ortak ka te drejte vote sipas perqindjes se secilit ne kuotat e kapitalit themelor te shoqerise.
Vendimet e Asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim nese nje nga ortaket nuk ka kerkuar mbledhjen e asamblese.Secili nga ortaket ka te drejten e tjetersimit te kuotave ose nje pjese te tyre,pasi merret vendim i Asamblese se ortakeve.Per cdo ceshtje te shqyrtuar nga ortaket mbahet procesverbal ne nje regjister te vecante.Vendimet e asmblese formulohen dhe firmosen nga te dy ortaket.

Asambleja zhvillon mbledhje te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Mbledhja e zakonshme thirret jo me pak se dy here ne vit,ne dhjetor per te miratuar programin ekonomik per vitin e ardhshem dhe ne mars per te miratuar bilancin ekonomik kontabel te shoqerise per vtin e kaluar.Ne mbledhje te jashtezakonshme shqyrtohen dhe vendoset per probleme qe kane te bejne me krijimin,bashkimin,ndarjen,shperberjen e shoqerise,ndryshimve ne Statutin e shoqerise dhe probleme te rendesishme themelore.Vendimet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme konsiderohen te vlefshme kur miratohen unanimisht nga ortaket e shoqerise.Asambleja mund te thirret edhe jashte qendres

se saj legale ,ne Shqiperi dhe jashte Shqiperise.Secili ortak qe ka te drejten e pjesemarrjes ne Asamble mund te perfaqesohet ne te edhe nga person tjeter i autorizuar me shkrim nga ortaku i shoqerise.

NENI 9

Vendimet ne emer te ortakeve nenshkruhen sipas parashikimeve te percaktuara ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.Ortaket marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:
-Miratojne strukturen organizative te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes ne te.
-Emerojne dhe shkarkojne Administratorin e shoqerise.Administrator i shoqerise caktohet zoti Agron Hysa.
-Ndryshojne dhe modifikojne statutin e shoqerise dhe kapitalin themeltar e objektin e veprimtarise se shoqerise,si dhe per ndryshimin e formes juridike te shoqerise.
-Miratojne llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.
-Miratojne prishjen e shoqerise para afatit te percaktuar ne aktin e Themelimit ose per kalimin e ketij afati.
-Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
-Riorganizimin,mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likujdimin e saj.
-Vendosjen e shoqerise ne peng,hipoteke apo siguri tjeter te ngjashme.
Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri vetem me miratimin e ortakeve,nepermjet Asamblese se Ortakeve.

NENI 10

Shoqeria “Vellezerit Hysa” sh.p.k vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj,ortaket e shoqerise mbartin rezikun per rezultatet e veprimtarise ekonomike se shoqerise ne nivelin e kapitalit themelor te shoqerise duke mos u pergjigjur me pasurite vetjake te realizuara ne veprimtari te tjera ekonomike per detyrimet e kesaj shoqerie.

NENI 11

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarive ekonomike te shoqerise,asambleja emeron administratore, organe te tjera kontrolli si dhe puneson punetore te aktiviteteve te ndryshme te cilet qendrojne ne detyre derisa te revokohen nga Asambleja ose largohen me deshiren e vet. Administratori i emeruar i ka te

gjitha kopetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji i jep shprehimisht asamblese se shoqerise.Ne kete rast shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve dhe administratori i emeruar pergjigjet ne menyre individuale. Administratorit te emeruar nuk i lejohet te kontraktoje ne cfaredo forme qofte qe te marre hua ne shoqeri te tjera,te jape pelqimin ne emer te shoqerise per paradhenie e te behet dorezenes apo garantoje ne emer te saj angazhimeve ndaj te treteve.

NENI 12

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen neprmjet kontrates se punes.Per ceshtjes qe nuk rregullohen me kontrate pune zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.Shoqeria merr persiper qe te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit e te Sigurimeve Shoqerore per te gjithe te punesuarit ne shoqeri,ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete Statut te Shoqerise.

NENI 13

Te punesuarit ne shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas statutit per moszbatimin e detyrave te ngarkuara dhe per demet qe ata i shkaktojne shoqerise.Ata mbajne pergjegjesi penale dhe administrative ne kryerjen e detyrave te tyre.Mosmarreveshjet e te punesuarve ne shoqeri zgjidhen nga Gjykata Shqiptare.Kur pala ankuese eshte person i huaj mosmarreveshja zgjidhet nga oragni i percaktuar ne kontraten e punes.

NENI 14

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike nese ne kontraten e punes nuk eshte parashikuar ndryshe,Administratori i emeruar nuk mund te marre cilesine e ortakut te shoqerise as te ushtroje nje aktivitet konkurrus te cfaredo lloji per llogari te tij ose te te treteve pervec atyre te autorizuar nga Administratori i Shoqerise.Per cdo shkelje ne kete drejtim administratori i emeruar pergjigjet per demet e shkatuara dhe largohet nga shoqeria.

NENI 15

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes te shoqerise.Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.Detyra mbi ruajtjen e sekretit te punes se shoqerise eshte e vlefshme edhe per ortaket e shoqerise.

NENI 16

Administratoret e shoqerise kane te drejte te perfaqesojne shoqerine edhe ne organet gjyqesore dhe gjykime,te caktoje e te pushoje avokate per ceshtje ne gjykim.

NENI 17

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me eksperte kontabel te autorizuar te emeruar me ose pa afat te caktuar me mundesi rizgjedhje dhe largimi nga puna.Ekspertet kontabel kontrollojne dhe garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta,te hartuara me sinqeritet dhe qe japin pasqyrim besnik te rezultave te operacioneve te vitit te kaluar financiar,te gjendjes financiare te trashegimise se shoqerise ne fund te ketij viti finaciar.Ata kontrollojne pershtatjen e kontabilitetit te shoqerise me legjislacionin ne fuqi.Ata jane pergjegjes ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet e nenvleresimet e tyre ne ushtrimin e funksioneve perkates.

NENI 18

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.Shoqeria nxjerr bilancin kontabel me llogarine Humbje-Fitime,inventaret dhe raportet perkates ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton raport me shkrim per adminstrimin.Raporti i administrimit inventaret bilancet dhe llogarite vjetore te hartuara i nenshtrohen miratimit nga Asambleja e Shoqerise brenda afatit prej tre muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve si me siper dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale i mbesin per perdorim ortakeve te shoqerise,te cilet i ndajne midis tyre ne perputhje me kuotat e secilit ne formimin e kapitalit themelor te shoqerise.

NENI 19

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni i plote i saj dokumentet themelues te shoqerise si dhe dokumentet normative q rregullojne marredheniet brenda shoqerise me te gjitha ndryshimet e bera deri ne ditet e fundit.Ne seline e shoqerise mbahen edhe te gjithe dokumentat e kontabilitetit per te bere vetekontrollin e shoqerise si dhe per kontrollet nga organet shtetore te autorizuara sipas ligjeve ne fuqi.Ne seline e shoqerise mbahen edhe protokolle te ndryshme dhe lista te personave qe jane autorizuar te perfaqesojne shoqerine.

KREU V

*SHPERBERJA DHE LIKUJDIMI*

NOTER ELBASAN



NENI 20

Shoqeria mund te shperbehet per shkaqet e meposhtme:a)me mbarimin e afatit te percaktuar nenin 3 te ketij statuti dhe ne rast ndryshimi te tij ne baze te dispozitave te ketij statuti me mbarimin e ketij afati te ri.b)me vendim te ortakeve.c)me humbjen e gjysmes se kapitalit themeltar mbasi te jete shpenzuar dhe fondi rezerve ne baze te nenit 72 te ligjit 7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare"ne rast se ortaket nuk marrin vendim per te plotesuar kapitalin ose zvogeluar ate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ne rastin e prishjes se shoqerise shoqeria do te likujdohet.Ortaket duhet te caktojne nje ose disa likujdatore.Likujdimi i shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionitt te vetem te kreut te 5 te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

NENI 22

Te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese qe duhet te aprovoje llogarite sociale keto llogari do te jene ne dispozicion te ortakeve ne seline e shoqerise.

NENI 23

Cdo mosmarreveshje qe do te linde ndermjet ortakeve dhe administratoreve zgjidhen me mirekuptim ne rast te kundert kopetente eshte Gjykata.

NENI 24

Shoqeria mund te vendose pjese te kapitalit te vet me shumice votash ne shoqeri te tjera.

NENI 25

Persa nuk eshte e parashikuar nga statuti i tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

O R T A K E T

E SHOQERISE "VELLEZERIT HYSA" SH.P.K

| Agron Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |
|---|---|---|
| Agron Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |